

## Vendim nr. 169 datë 17.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 17.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (M) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** **MARINAQE BULLI**, përfaqësuar nga avokat Qani Hasa, me prokurë të përgjithshme.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-481, datë 17.03.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 41, 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Pasuria e shtetasit të ndjerë L.G. përbëhej nga 990 m<sup>2</sup> tokë, një shtëpi njëkatëshe prej 44 m<sup>2</sup> dhe oborr prej 180 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Fier. Pasi ky i fundit ka ndërruar jetë, e veja

e tij S.G. u ka dhuruar dy nipërve të mitur H.Xh. dhe M.Xh. pjesën e saj të pasurisë me akt dhurimi nr. 2275, datë 16.05.1956. Ndërkohë gjysma tjetër e pasurisë së L.G. është trashëguar nga shtetasja Marinaqe Buli (Gava) (*kërkuesja*) dhe trashëgimtarja Dh.T. (halla e kërkueses) me dëshmi trashëgimie të Dhomës së Noterëve Vlorë nr. 274 rep., nr. 101 kol., datë 27.03.2014. Kërkuesja rezulton se ka hyrë si trashëgimtare e vetme ligjore e pasurisë që babai i saj i ndjerë N.G. kishte trashëguar nga i ati i tij L.G.

2. Pjesa e pasurisë e trashëguar nga e ndjera Dh.T. me dëshmi trashëgimie të Dhomës së Noterëve Vlorë nr. 616 rep., nr. 221 kol., datë 07.02.2015, i ka kaluar të birit A.T. Për të ndjerën Dh.T. nga Dhoma e Noterëve Vlorë është lëshuar edhe dëshmia tjetër e trashëgimisë nr. 313 rep., nr. 195 kol., datë 27.04.2015, e ndarë midis tetë trashëgimtarëve të tjerë (ku pjesëtarë janë edhe H.Xh. edhe M.Xh.).

3. Nga pasuria e L.G., pjesa e përbërë nga 336 m<sup>2</sup> truall dhe 72 m<sup>2</sup> ndërtim është regjistruar në pronësi të trashëgimtarit H.Xh. me vërtetimin e regjistrimit hipotekar nr. 542 të datës 23.09.2003. Po ky shtetas me lejen e ndërtimit nr. 8, datë 28.12.2005 të Këshillit të Rregullimit të Territorit Fier në atë pasuri ka ndërtuar një banesë dykatëshe, për të cilën dispononte certifikatë për vërtetimin e pronësisë, datë 10.07.2008, për sipërfaqen totale të truallit 336 m<sup>2</sup> dhe 139 m<sup>2</sup> ndërtim.

4. Lidhur me pronën e regjistruar në emër të H.Xh. kërkuesja ka pretenduar bashkëpronësinë dhe në datën 03.04.2014 ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Në këtë kërkesëpadi kërkuesja ka kërkuar detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier (*ZVRPP, Fier*) që të çregjistronte pronën në emër të H.Xh. dhe këtë pronë ta regjistronte në emër të saj dhe trashëgimtares Dh.T. nga 1/2-ën pjesë për secilën. Gjithashtu, kërkuesja ka kërkuar edhe vendosjen e masës së sigurimit të padisë.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 738, datë 28.05.2015, ka vendosur masën e sigurimit të padisë, pranimin e kërkesëpadisë së kërkueses dhe çregjistrimin e pronës së H.Xh., duke urdhëruar ZVRPP-në, Fier ta regjistronte atë në emër të kërkueses dhe Dh.T. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur H.Xh, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3285, datë 11.07.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke arsyetuar se paditësja nuk kishte paraqitur asnjë kërkesë për regjistrimin e titullit të pronësisë pranë ZVRPP-së, Fier, duke ngritur një padi që nuk mund të ngrihej, pasi i mungonte shkaku ligjor. Ndaj këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar

prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-481, datë 17.03.2022, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49, datë 03.05. 2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

8. Në datën 22.04.2024 (sipas shërbimit postar), kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 17.05.2024.

## II

### Pretendimet e kërkueses

9. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar i është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

9.1.1. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka zhvilluar gjykimin pa e njoftuar kërkuesen, duke mos dëgjuar pretendimet e saj. Ajo gjykatë ka njoftuar vetëm palën e paditur, duke anashkaluar në këtë mënyrë pretendimet e kërkueses dhe duke vendosur në disfavor të saj.

9.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë një interpretim të plotë, të saktë dhe shterues për sa i takon titullit të pronësisë së kërkueses.

9.1.3. *Sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë, në rastin konkret, nuk ka marrë parasysh praktikën shumë të konsoliduar në vend në rastet kur pronari nuk është zhveshur asnjëherë nga prona dhe të drejtën që trashëgimtari ta gëzojë e trashëgojë lirshëm pronën e trashëgimlënësve të tij.

9.2. *E drejta e pronës private*, pasi me vendimin e tij Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ia ka marrë atë padrejtësisht kërkueses, duke shkelur dhe cenuar rëndë garantimin që i bën Kushtetuta pronës private.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkueses*

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Kolegji çmos se kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

12. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesja përpara se ajo t’i drejtohet kësaj Gjykate.

13. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, kërkuesja ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka zhvilluar gjykimin pa e njoftuar kërkuesen, duke mos dëgjuar pretendimet e saj. Sipas saj, ajo gjykatë ka njoftuar vetëm palën e paditur, duke anashkaluar në këtë mënyrë pretendimet e kërkueses dhe duke vendosur në

disfavor të saj. Kolegji konstaton se ky pretendim rezulton se është ngritur për herë të parë nga kërkuesja në ankimin kushtetues individual. Për sa më sipër, lidhur me këtë pretendim, kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, për rrjedhojë ato nuk mund të merren në shqyrtim.

15. Pretendimet e tjera që kanë të bëjnë me cenimin e standardit të arsytimit të vendimit, parimit të sigurisë juridike dhe cenimin e së drejtës së pronës private, janë ngritur në thelb përpara gjykatave të zakonshme ose kanë të bëjnë me vendimin gjyqësor të Gjykatës së Lartë, i cili ka përbyllur procesin gjyqësor për shqyrtimin e themelit të çështjes. Në këtë situatë, Kolegji çmon se kërkuesja nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimeve të kundërshtuara, për rrjedhojë e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohet Gjykatës.

16. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijene efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijene konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijene konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesja, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 17.03.2022, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 22.04.2024. Për qëllime të këtij shqyrtimi, Gjykatës së Lartë i është kërkuar informacion në lidhje me momentin në të cilin ky vendim është bërë i disponueshëm për palët. Me informacionin e datës 28.05.2024, Gjykata e Lartë ka sqaruar se vendimi nr. 00-2022-481, datë 17.03.2022 i Kolegjit Administrativ është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 13.04.2022, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët.

18. Ndërkohë nga ana e kërkueses, në ankimin kushtetues individual pretendohet se vendimi i arsyetuar i është komunikuar në datën 28.01.2024, pas kërkesës së saj, pa dhënë argumente të tjera për mënyrën në të cilën ka marrë dijëni për vendimin.

19. Kërkesja ka paraqitur edhe një kopje të rekursit të depozituar në Gjykatën e Lartë, nga i cili rezulton se përfaqësuesi i saj me prokurë të posaçme, në kohën e depozitimit në Gjykatën e Lartë, ka shënuar edhe të dhënat e postës elektronike (*e-mail*), ndërkohë që, aktualisht, rezulton se kërkesja përfaqësohet nga një tjetër përfaqësues ligjor. Lidhur me këtë fakt, nga aktet që gjenden në dosjen gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, rezulton se nga ana e Gjykatës së Lartë nuk është njoftuar përfaqësuesi i kërkueses nëpërmjet *e-mail-it*.

20. Për sa më sipër, në kushtet kur përfaqësuesi i kërkueses kishte lënë adresën e *e-mail-it* dhe nga ana e Gjykatës së Lartë nuk është njoftuar, Kolegji çmon që si datë e marrjes dijëni efektivisht do të konsiderohet data 28.01.2024. Për rrjedhojë, duke konsideruar këtë të fundit si datën e marrjes dijëni efektivisht për vendimin e arsyetuar objekt të këtij ankimi, rezulton se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor dhe kërkesja legjitimohet *ratione temporis*.

21. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, në rastin konkret, kërkesja, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit*, cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, si dhe cenimin e *së drejtës së pronës*.

22. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, kërkesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë, në rastin konkret, nuk ka marrë parasysh praktikën shumë të konsoliduar në vend në rastet kur pronari nuk është zhveshur asnjëherë nga prona dhe të drejtën që trashëgimtari ta gëzojë e trashëgojë lirshëm pronën e trashgimlënësve të tij.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 3, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Duke mbajtur në konsideratë për sa më sipër, Kolegji konstaton se për të mbështetur pretendimet e saj për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, kërkesja, në thelb, ka ngritur argumente në lidhje me mosrespektimin nga Kolegji Administrativ të jurisprudencës së vetë Gjykatës së Lartë, që për nga natyra e tyre kanë të bëjnë me çështje të interpretimit e zbatimit të ligjit prej saj, duke mos sjellë asnjë argument konkret kushtetues për cenimin e të drejtave të saj kushtetuese. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se në kushtet kur kërkesja nuk ka arritur të argumentojë cenimin e të drejtave kushtetuese për shkak të mënyrës se si ka vepruar Gjykata e Lartë në zgjidhjen e çështjes konkrete, këto pretendime mbeten me natyrë të ligjore, ndaj nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe, për këtë arsye, nuk mund të merren në shqyrtim.

25. Për sa i përket pretendimit për *cenimin e së drejtës së pronës*, sipas nenit 41 të Kushtetutës, Kolegji mban në konsideratë se argumentet e dhëna nga kërkesja lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar, ndaj, për rrjedhojë, çështja do të analizohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

26. Për sa më lart, Kolegji çmon se për të përcaktuar nëse kërkeses i është cenuar e drejta e pronës, është e rëndësishme të analizohet në themel nëse procesi ligjor i zhvilluar nga gjykata, e cila ka dhënë vendimin që kundërshtohet prej tij, ka përmbushur standardet e procesit të rregullt në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor që *prima facie*, përfshihet në kompetencën e kësaj Gjykate dhe do të analizohet në vijim.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit*

27. Kërkesja, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë një interpretim të plotë, të saktë dhe shterues për sa i takon titullit të pronësisë së kërkeses.

28. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij, ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i standardeve të mësipërme është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore



të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, pasi ajo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, por në aspektin e kontrollit kushtetues ajo verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo standardet kushtetuese (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-481, datë 17.03.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja. Ajo gjykatë ka argumentuar se rekursi i paraqitur nga kërkuesja nuk përmbante shkaqe nga ato të përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe se nga shqyrtimi në tërësi i akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore vlerësohet se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të ligjit. Më tej ajo gjykatë arsyeton, gjithashtu, se pretendimet e ngritura në rekurs ngrenë çështje të vlerësimit të provave, të cilat dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

30. Nga analiza e vendimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se ai përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ato mbështesin qëndrimin e tyre të shprehur në dispozitiv. Ndonëse me arsyetim të kufizuar, ky vendim nuk rezulton të ketë kundërthënie dhe pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv. Për sa i përket këtij arsyetimi, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se ai nuk cenon standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjithashtu, Kolegji vëren se interpretimi dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme nuk janë çështje që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës, për sa kohë nuk argumentohet se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të kërkueses, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor.



32. Si konkluzion, Kolegji çmon se edhe vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në tërësinë e tij paraqitet i rregullt në formë, i qartë, koherent dhe pa kundërthënie në përmbajtje, duke respektuar standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe nuk rezulton që interpretimi i ligjit të ketë qenë arbitrar e në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

33. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.